



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 4102/ Prot.

Tiranë, më 30.06. 2025

URDHËR

NR. 283, DATË 30.06.2025

PËR

**HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL NË
“PROGRAMIM WEB DHE DIZENJIM DIGJITAL”, NË UNIVERSITETIN “ISMAIL
QEMALI”, VLORË**




Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe të neneve 35 dhe 72, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe shkronjës “g”, të pikës 2, të urdhrit nr. 113, datë 26.03.2024, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Ana Kapaj”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Hapjen e programit të studimit me karakter profesional në “Programim Web dhe Dizajn Digjital”, me 120 kredite dhe kohëzgjatje 2 vite akademike (4 semestra), në gjuhën shqipe, me kod 52PP0613S, me formë studimi me kohë të plotë.
Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë profesionale në “Programim Web dhe Dizajn Digjital”, në Fakultetin e Shkencave Teknike dhe Natyrore, në Universitetin “Ismail Qemali”, referuar nivelit 5, të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
2. Veprimtaria akademike në programin profesional të studimit në “Programim Web dhe Dizajn Digjital”, në Fakultetin e Shkencave Teknike dhe Natyrore, në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë, fillon sipas legjislacionit në fuqi.
3. Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë, të marrë masa që programi i studimit t’i nënshtrohet procesit të akreditimit, sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
4. Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë, të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin e formës së diplomës së këtij programi studimi, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe të përshtatë aktet e brendshme rregullatore, në zbatim të këtij urdhri.

5. Ministria e Arsimit dhe Sportit ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin e arsimit të lartë, në zbatim të këtij urdhri.
6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportin, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Konceptoi:	M. Kamberi	
	A. Manja	
Miratuan:	B. Biçoku	
	V. Koçi	
Konfirmuan:	J. Çollaku	
	E. Tola	
Data e shkresës tek SP:	___.06.2025	
Nr. i kopjeve të shkresës:	5	

ZËVENDËSMINISTRI

